

Në bazë të nenit 59 të Ligjit për rregullimin e hapësirës dhe ndërtimin e objekteve (“Fl. zyr. MZ”, nr. 51/08, 40/10, 34/11, 47/11, 35/13, 39/13 dhe 33/14), nenit 34, paragrafi 1 dhe 3 dhe nenit 40, paragrafi 2, pika 3 të Ligjit për pronën shtetërore (“Fl. zyr. MZ”, nr. 21/09 dhe 40/11), nenit 28 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për marrëdhëniet pronësore juridike (“Fl. zyr. MZ”, nr. 19/09), nenit 33 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 45 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (“Fl. zyr. RMZ”, nr. 42/03, 28/04, 75/05, 13/06 dhe “Fl. zyr.MZ”, nr. 88/09, 3/10, 38/12, 10/14 dhe 57/14) dhe nenit 36, paragrafi 2 dhe 3 dhe nenit 42, paragrafi 1 pika 9 të Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës”, nr. 5/07, 9/09 dhe 16/11), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më 11. 07. 2018 v., ka nxjerrë

V E N D I M I N

për blerjen e tokës me qëllim të kompletimit të parcelës urbanistike nr. 79 nga ID PDU “Ulqini – Qyteti” për lokalitetin “Pinjeshi 1” Komuna e Ulqinit

Neni 1

I lejohej Shaqiri R. Rumanit blerja e parcelës kadastrale nr. 3618/13 me sipërfaqe prej 2 m² me kulturë tokë jji pjellore nga F.P. nr. 604 KK Ulqin, si pronë e Malit të Zi – bartës i të drejtës së disponimit Komuna e Ulqinit si dhe një pjesë e parc. kad. nr. 3462 me sipërfaqe prej 68 m² nga F.P. nr. 4377 KK Ulqin, me listën e koordinatave:

Nr.	Y	X
1	6600961.39	4642753.68
2	6600937.84	4642731.33
3	6600933.18	4642739.94
4	6600930.99	4642745.24
5	6600927.21	4642742.31
6	6600921.41	4642749.75

me qëllim të kompletimit të parcelës urbanistike nr. 79, e formuar me Ndryshimet dhe plotësimet e PDU “Ulqini – qyteti” për lokalitetin “Pinjeshi 1”.

Neni 2

Parcela urbanistike e përmendur në nenin 1 të këtij Vendimi përbëhet prej parcelës kadastrale e cila është subjekt i blerjes, dhe një pjesë të parcelës kadastrale nr. 3462 nga F.P. nr. 4377 KK Ulqin me sipërfaqe prej 825 m² pronësi e Shaqiri R. Rukmanit.

Neni 3

Patundshmëria nga neni 1 i këtij Vendimi blehet me kompensim në shumën prej **200,00 €** për 1 m², që në total është **14.000,00 €**.

Kompensimi në shumën e përmendur është caktuar nga ana e Marnikoviq Vinko ekonomist vlerësues i autorizuar për vlerësimin e vlerës së patundshmërive në territorin e Komunës së Ulqinit.

Neni 4

Autorizohet Kryetari i Komunës së Ulqinit që me Shaqiri R. Rukmanit të lidhë kontratë për shitblerjen e patundshmërisë nga neni 1 i këtij Vendimi, me të cilën do të rregullohen të gjitha të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

Po ashtu jepet pëlqimi me qëllim të fshirjes së ndalesës së shitjes dhe ngarkimit për sipërfaqen nga neni 1 i këtij Vendimi

Neni 5

Personi nga neni 1 i këtij Vendimi e fiton të drejtën e regjistrimit të drejtës së pronësisë në patundshmëri tek Drejtoria për patundshmëri të Malit të Zi – Njësia rajonale Ulqin, pas shlyerjes së obligimit të kontraktuar.

Nëse personi nga paragrafi 1 i këtij neni në afat prej 6 (gjashtë) muajsh nuk e lidhë kontratën nga neni 4 i këtij Vendimi dhe nuk i shlyen detyrimet ky Vendim pushon së qeni i vlefshëm.

Neni 6

Palët shprehimisht autorizojnë Sekretariatën për mbrojtjen e pasurisë që mund të bëjë përmirësime, por vetëm dhe ekskluzivisht të atyre që kanë dalë me rastin e daktilografimit të këtij Vendimi

Neni 6

Tatimin në qarkullim të patundshmërisë e paguan blerësi.

Neni 7

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës.

Numër: 02-130/18-7

Ulqin, më 11. 07. 2018 viti

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

KRYETARI

Dr. Ilir Çapuni, d.v.